



СОЈУЗ НА МАТЕМАТИЧАРИ НА МАКЕДОНИЈА


GARA E GJASHTË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE

02.03.2019

Klasa e katërt

1. Në një fuçi ka 14 litra lëng portokalli, ndërsa në një fuçi tjetër 8 litra lëng të njëjtë. Lëngu paketohet nëpër shishe me nga 2 litra. Sa shishe gjithsej janë mbushur me lëngun e të dy fuçive?

2. Numëro sa trekëndësha dhe sa segmente janë paraqitur në vizatimin djathtas. Emërtoi trekëndëshat dhe segmentet me ndihmën e kulmeve të tyre. Çfarë ka më shumë dhe për sa herë?



3. Në qoftë se shtëpiakja Mira ble nga pazari 20 vezë, do ti mbeten 30 denarë nga shuma që e kishte me vete, ndërsa që të blejë 30 vezë, i mungojnë 20 denarë. Sa denarë kishte Mira me vete në pazar?
4. Ana, Mira dhe Luli së bashku kishin 1200 denarë dhe vendosën të blejnë dhuratë për ditëlindjen e shoqes së tyre Drita. Pasi dhanë për dhuratë: Ana 210, Mira 186 dhe Luli 174 denarë, secilit prej tyre i mbeti e njëjta shumë parash. Sa para kishte secili prej tyre përpara blerjes së dhuratës?

Koha në disponim 120 minuta

Çdo ushtrim vlerësohet me 25 pikë



СОЈУЗ НА МАТЕМАТИЧАРИ НА МАКЕДОНИЈА

**GARA E GJASHTË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR
NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE**

02.03.2019

Klasa e pestë

1. Me shifrat 0, 1, 5 dhe 6, pa përsëritje të shifrës, formoje numrin më të madh tek të plotpjestueshëm me 5, ndërsa më pas formoje numrin më të vogël më të madh se 1000 i cili është i plotpjestueshëm me 5. Cilët janë ata numra? Sa është diferenca e tyre?
2. Dy punëtorë mbaruan një punë dhe fituan 1632 denarë së bashku. Kur punëtori i parë nga fitimet e tij shpenzoi 360 denarë, ndërsa i dyti 72 denarë, atëherë secilit i mbeti shumë e njëjtë parash. Nga sa fitoi secili punëtor?
3. Në test duhet të zgjidhen 20 ushtrime. Për çdo ushtrim të zgjidhur nxënësi fiton nga 4 pikë, ndërsa për çdo ushtrim të pazgjidhur humbet 3 pikë. Në qoftë se në fund nxënësi kishte 38 pikë, sa ushtrime zgjidhi.
4. Në qoftë se njërën brinjë të katrorit e zmadhoni tre herë, ndërsa tjetrën e zmadhoni dy herë, do të fitojmë drejtkëndësh me suprinë $96cm^2$. Përcaktoje diferencën midis perimetrave të drejtkëndëshit dhe katrorit.

Koha në disponim 120 minuta

Çdo ushtrim vlerësohet me 25 pikë



СОЈУЗ НА МАТЕМАТИЧАРИ НА МАКЕДОНИЈА

GARA E GJASHTË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE

02.03.2019

Klasa e gjashtë

1. Një tren kishte 159 pasagjerë kur ndaloi në një stacion. Dy të tretat e pasagjerëve zbritën, ndërsa 38 pasagjerë u ngjitën në tren. Sa pasagjerë kishte treni kur u largua nga ky stacion hekurudhor? Në qoftë se treni kishte gjashtë vagona me numër të barabartë pasagjerësh, nga sa pasagjerë kishte në secilin vagon?
2. Sahati i Mirës ditën e parë mbeti mbrapa 0,16 minuta, ndërsa çdo ditë pasardhëse mbetej me 0,02 minuta më shumë. Sa do të mbetet mbrapa sahati i Mirës pas 10 ditësh, në qoftë se nuk rregullohet saktësia e tij?
3. Shuma e këndeve α , β dhe γ është i barabartë me 180° . Në qoftë se α është dy herë më i madh se β , ndërsa β është tre herë më i madh se γ , përcaktoi këndet α , β dhe γ .
4. Ariani për 4 ditë lexoi një libër me 114 faqe. Ditën e dytë lexoi 10 faqe më shumë sesa të parën, ndërsa ditën e tretë lexoi 5 faqe më pak sesa lexoi ditën e parë dhe të dytë së bashku. Ditën e katërt Ariani lexoi aq faqe sa lexoi ditën e dytë dhe të tretë së bashku. Sa faqe lexoi Ariani çdo ditë?

Koha në disponim 120 minuta

Çdo ushtrim vlerësohet me 25 pikë



СОЈУЗ НА МАТЕМАТИЧАРИ НА МАКЕДОНИЈА

GARA E GJASHTË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE

02.03.2019

Klasa e shtatë

1. Luli ka një pako me 24 bonbone. Ai 25% të bonboneve ia dha vëllait të tij. Më pas Luli hëngri $\frac{1}{3}$ e bonboneve të mbetura. Bonbonet që i mbetën ia dha motrës së tij. Sa përqind të bonboneve fitoi motra e Lulit?

2. Llogarite vlerën e shprehjes

$$6 : \frac{1}{3} - 0,8 : \frac{1,5}{\frac{3}{2} \cdot 0,4 \cdot \frac{50}{1 : \frac{1}{2}}} + \frac{1}{4} + \frac{1 + \frac{1}{2} \cdot \frac{1}{0,25}}{6 - \frac{46}{1 + 2,2 \cdot 10}} .$$

3. Në trekëndëshin dybrinjënjëshëm ABC me bazë AB , brinja AC është zgjatur përtej kulmit C deri në pikën D . Perimetri i trekëndëshit BCD është 18 cm , ndërsa i trekëndëshit ABD është 32 cm . Llogarite gjatësinë e bazës AB .

4. Vërteto që nuk egzistojnë 22 numra natyrorë të njëpasnjëshëm shuma e të cilëve plotpjestohet me 22.

Koha në disponim 120 minuta

Çdo ushtrim vlerësohet me 25 pikë



СОЈУЗ НА МАТЕМАТИЧАРИ НА МАКЕДОНИЈА

GARA E GJASHTË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE

02.03.2019

Klasa e tetë

1. Çmimi i një karrigeje është zvogëluar me 30%. Zbritja është 450 denarë. Sa është çmimi i ulur i karriges? Familja Markovski do të blejë 6 karrige. Por, atëherë fitojnë një zbritje të re për 5%. Sa paguan në fund për të gjashtë karriget?
2. Janë dhënë tre pika jokolineare A , O_1 dhe O_2 . Le të jetë A_1 pika simetrike qendrore e A në lidhje me O_1 , ndërsa A_2 pika simetrike qendrore e A në lidhje me O_2 . Në qoftë se $\overline{O_1O_2} = 2019m$, të llogaritet gjatësia e segmentit A_1A_2 .
3. Në qoftë se një numër dyshifror e pjestojmë me shumën e shifrave të tij fitojmë herës 6 dhe mbetje 2. Në qoftë se të njëjtin numër dyshifror e pjestojmë me prodhimin e shifrave të tij fitojmë herës 5 dhe mbetje 2. Cili është ai numër?
4. Vërteto që numri $7^{2020} - 1$ plotpjestohet me 10.

Koha në disponim 120 minuta

Çdo ushtrim vlerësohet me 25 pikë



СОЈУЗ НА МАТЕМАТИЧАРИ НА МАКЕДОНИЈА

GARA E GJASHTË MATEMATIKORE NË KOMUNA PËR
NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE

02.03.2019

Klasa e nëntë

1. Miri merr pjesë në një garë me biçikleta. Rruga është e gjatë 125km . 85km e para i përshkoi për $2\frac{1}{2}h$. Pjesën e mbetur të rrugës e përshkoi për $2h$. Kur e ngiste më shpejt biçikletën, në pjesën e parë të rrugës apo në të dytën dhe për sa?
2. Llogarite vlerën e shprehjes
 $(\sqrt{2} + \sqrt{3} + \sqrt{5})(\sqrt{2} - \sqrt{3} - \sqrt{5})(\sqrt{2} + \sqrt{3} - \sqrt{5})(\sqrt{2} - \sqrt{3} + \sqrt{5})$.
3. Në rrethin $k(O, r)$ është brendashkruar trekëndëshi ABC i tillë që
 $\sphericalangle A : \sphericalangle B : \sphericalangle C = 2 : 3 : 4$.
Përcaktoi madhësitë e këndeve $\sphericalangle AOB$, $\sphericalangle AOC$ dhe $\sphericalangle BOC$.
4. Vërteto që në qoftë se brinjët e një trapezi janë normale me njera tjetren, atëherë shuma e katrorëve të diagonaleve të tij është e barabartë me shumën e katrorëve të bazave.

Koha në disponim 120 minuta

Çdo ushtrim vlerësohet me 25 pikë